

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 14, datë 28.03.2019

**Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 32,
datë 23.10.2015 “Mbi miratimin e Rregullores “Për administrimin e
rreziqeve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 44, pika 1, shkronja “c”, të nenit 52, pika 1, shkronjat “c” dhe “dh” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, shkronja “k” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.24, datë 31.10.2018, të nenit 14, pika 4 shkronja “a” dhe pika 5 të Rregullores “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.25, datë 31.10.2018, të nenit 8, pika 3, shkronja “j” të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm:

V E N D O S I:


1. Në Rregulloren “Për administrimin e rreziqeve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, bashkëlidhur vendimit të Këshillit Drejtues nr. 32, datë 23.10.2015, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Neni 16 të ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

Neni 16

Shkalla e rrezikut dhe vlerësimi përmbledhës

1. *Vlerësimi i rreziqeve kryhet sipas kombinimit dhe shkallëzimit në matricën e mëposhtme:*



KËSHILLI DREJTUES

Matrica A: Vlerësimi i rreziqeve sipas shkallës së tyre

Mundësi Ndikim	Mundësi e lartë ndodhjeje (3)	Mundësi mesatare ndodhjeje (2)	Mundësi e ulët ndodhjeje (1)
I rëndësishëm (3)	9	6	3
Mesatar (2)	6	4	2
I ulët (1)	3	2	1

- Sektori i Analizës së Riskut vlerëson një herë në gjashtë muaj shkallën e rreziqeve të identifikuar më parë dhe atyre të identifikuar rishtazi.
- Sektori i Analizës së Riskut vendos përfundimisht për shkallën e rrezikut të njoftuar nga njësitë organizative të Agjencisë.
- Sektori i Analizës së Riskut bën një vlerësim të përmblëdhur për të gjitha rreziqet sipas regjistrave të krijuar sipas nenit 13. Sektori i Analizës së Riskut përdor koeficientë për secilin rrezik sipas vlerësimit respektiv të përcaktuar në tabelën më poshtë:

Vlerësimi i rrezikut	1	2	3	4	6	9
Koeficienti	0.5	0.7	0.9	1.1	1.3	1.5

- Vlerësimet e rreziqeve individuale të ponderuara me koeficientët më lart mblidhen dhe shuma aplikohet në ekuacionin:

$$Y = a X + b$$


X = shuma e ponderuar e vlerësimeve të rreziqeve individuale

a = koeficient i cili ndryshon në varësi të numrit të rreziqeve

b = koeficient i cili ndryshon në varësi të koeficientëve

Y = rezultati vlerësimit përmblëdhës

Rezultati shpreh vlerësimin përmblëdhës në një shkallë rritëse të rrezikut nga 1 në 10.



KËSHILLI DREJTUES

b) Në pikën 6 të nenit 18, fjalia e dytë riformulohet me përmbajtjen si vijon:

Ky raport ndër të tjera përmban vlerësimin përmbledhës, një riklasifikim të rreziqeve të identifikuar, si dhe një analizë të mënyrave të zbatuara për minimizimin e tyre.

2. Ngarkohet Sektori i Analizës së Riskut për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar

